

NJOFTIME FITUESI PËR **MINIKONKURS PËR NJË KONTRATË** **TË ZHVILLUAR NË MARRËVESHJET** **KUADËR**

BASHKIA TIRANË **NJOFTIM FITUESI** **(MINIKONKURS)**

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Noor Engineering” sh.p.k
Rruga “Myslym Shyri”, Shk.1,Ap.45, Tiranë;

Procedura e prokurimit/Lotit: “Procedurë e Kufizuar” me Marrëveshje Kuadër Minikonkurim.

Numri i procedurës / Referenca e lotit: REF-55909-07-22-2025

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është Kolaudimi i punimeve për objektin: “Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rrugët Marie Kraja – Kokonozët – Zana Floqi – Filip Shiroka”.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Fondi limit: 41,397 (dyzet e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2025, miratuar me VKB Nr.131, datë 18.12.2024, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2025”.

Kohëzgjatja e kontratës: 30 (tridhjetë) ditë kalendarike, duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.

Me anë të kësaj ju informojmë se ofertuesi i mëposhtëm ka marrë pjesë në këtë procedurë me këtë vlerë të ofruar:

- | | |
|---|-----------------|
| 1. Operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” sh.p.k
Vlera e ofertës = 23,000 (njëzet e tre mijë) lekë pa TVSH. | NUIS K72113010E |
| 2. Operatorit ekonomik “INFRATECH” sh.p.k
Vlera e ofertës = 21,000 (njëzet e një mijë) lekë pa TVSH. | NUIS K91628001D |
| 3. Operatorit ekonomik “NET - GROUP” sh.p.k
Vlera e ofertës = 18,000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH. | NUIS L72023002P |

- 4.** Bashkimi i Operatorëve ekonomik “STATENG”sh.p.k & “MCE”sh.p.k NUIS L98819501J & L72203065K

Vlera e ofertës = 40,000 (dyzet mijë) lekë pa TVSH.

- 5.** Bashkimi i Operatorëve ekonomik “GRAMA”sh.p.k & “ZENIT & CO”sh.p.k NUIS J77304712J & K61731002D

Vlera e ofertës = 41,000 (dyzet e një mijë) lekë pa TVSH.

- 6.** Operatorit ekonomik “Noor Engineering” sh.p.k

NUIS M41919024C

Vlera e ofertës = 17,000 (shtatëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Në këtë fazë nuk ka operatorë ekonomikë të s’kualifikuar:

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “Noor Engineering” sh.p.k me adresë: Rruga “Myslym Shyri”, Shk.1,Ap.45, Tiranë; se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 17,000 (shtatëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.